



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 04.07.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Prezantimi i projektligjit “Për një shtesë në ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar” (*Relatim, pyetje-përgjigje, diskutim në parim*).

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Jorida Tabaku, Anastas Angjeli, Blerina Gjylameti, Evis Kushi, Antoneta Dhima, Arben Pëllumbi, Ervin Bushati, Ilir Xhakolli, Roland Xhelilaj, Xhevit Bushaj, Edmond Spaho, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Agron Shehaj, Edmond Haxhinasto, Përparim Spahiu, si dhe deputetë të tjerë të Partisë Demokratike.

Mungojnë:

Reme Lala dhe Dashamir Shehi.

Të ftuar:

Elton Haxhi – Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Nikolla Lera – Drejtor i Përgjithshëm i Politikave të Makroekonomisë, Çështjeve Fiskale dhe Punësimit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Enkeleda Bako – Përgjegjëse Sektori në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Erion Braçe – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit Parlamentar për Ekonominë dhe Financat.

Sot në rendin e ditës së punës së këtij komisioni kemi prezantimin e projektligjit “Për një shtesë në ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”. Për të prezantuar projektligjin kemi prezent në komision zëvendësministrin e Financave dhe Ekonomisë, zotin Elton Haxhi. Relatore e komisionit lidhur me këtë projektligj është zonja Evis Kushi.

Do të procedojmë me prezantimin e projektligjit nga ana e zotit zëvendësministër dhe pastaj me relatoren e komisionit, zonjën Kushi, për të vijuar më pas me pyetjet dhe diskutimet nga deputetët, në qoftë se do të ketë.

(Deputetja Tabaku flet pa mikrofon.)

E doni fjalën për procedurë?

Jorida Tabaku – Po.

Të nderuar kolegë,

Ditën e djeshme në komisionet parlamentare të gjithë deputetët e opozitës u ndodhën përballë një farse në mbrojtjen e aferës më të madhe korruptive, që i bënë deputetët e maxhorancës kontratës së prezantuar njëkohësisht nga Ministria e Kulturës, Bashkia e Tiranës dhe nga Ministria e Financave.

Ne u ndodhëm përballë nëpunësve të shtetit, që nuk dinin të kthenin përgjigje se nuk e kishin lexuar kontratën; që nuk dinin të kthenin përgjigje as për kushtet minimale të kontratës; që nuk kishin dijeni se çfarë po ndodhte me pronën publike dhe private dhe nuk kishin dijeni as për atë çfarë kishin firmosur.

Kjo na bën të dyshojmë se kjo kontratë nuk është prodhuar në zyrat e shtetit, pra kjo kontratë dhe kjo aferë korruptive, që u diskutua dhe në komisionet parlamentare, nuk mund të jetë prodhuar në zyrat e shtetit përderisa vetë zyrtarët e shtetit nuk dinin ta mbronin atë, ashtu siç edhe ministrja e Kulturës nuk dinte ta mbronte, madje nuk dha asnjë informacion!

Grabitja që i është bërë pronës publike dhe pronës private në këta pesë vjet është e pakrahasueshme. Grabitja që po i bëhet pronës publike me një ligj të vetëm, që po vjen këtu në parlament, është e pakrahasueshme. Nuk ka ndodhur asnjëherë që me një ligj të falen dhe të grabiten 5500 metra në qendër të Tiranës, për t’iu dhënë një ndërtuesi për ta zhvilluar

pronën publike! Nuk ka ndodhur asnjëherë që parlamenti të kthehet në një zyrë që jep leje ndërtimi!

Kemi diskutuar këtu shpeshherë për kriteret që Shqipëria duhet të plotësojë për hapjen e negociatave; kemi diskutuar për krimin dhe korrupsionin, por, në fakt, kemi harruar edhe një kriter, shumë të rëndësishëm, që është prona, dhe në këta pesë vjet qeveria shqiptare ka një bilanc jashtëzakonisht negativ për pronën, duke pasur parasysh që ka hartuar jo një, por tre ligje me anën e të cilave u grabit pronën pronarëve dhe vazhdon me aktin e fundit, grabitjen e pronës publike.

Zoti kryetar, unë dua të ngre një shqetësim.

Kameramanët më thonë se këtu nuk ka transmetim live.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dua të kemi akses në media dhe mbledhjet e komisionit, ashtu siç e parashikon Rregullorja, të jenë live dhe të reflektohen për të gjithë publikun që nuk e ndjek dot.

Erion Braçe – E nderuara zonja Tabaku, e para dhe, mbi të gjitha, mbledhjet e komisionit, sipas Rregullores, kanë detyrimin të jenë të hapura, jo të transmetuara live.

E dyta, me këtë punë nuk merrem unë, se nuk jam drejtor televizioni.

Cilido që dëshiron të transmetojë, është i gatshëm, le të transmetojë, le të bëjë çfarë të dojë brenda sallës, por vetëm të ruajë rendin dhe qetësinë këtu brenda.

Për pjesën tjetër, le të transmetojë, të bëjë çfarë të dojë. Unë nuk kam asnjëlloj detyrim që të transmetoj ndonjë gjë, pasi nuk jam drejtor televizioni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëroni!

Jorida Tabaku – Unë kërkoj pesë minuta pushim derisa televizionet të bëhen gati për të bërë transmetimin live.

Erion Braçe – Jo, pra, tani, se ky komision nuk funksionon si pica taksi!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jorida Tabaku – Ky komision duhet të jetë i hapur dhe transparent.

Erion Braçe – Domethënë që dikush bën porosinë...

Jorida Tabaku – Që përpara mbledhjes së këtij komisioni, zoti kryetar, i kërkoja zyrës së shtypit të parlamentit...

Erion Braçe – Zonjë, një sekondë!

Edhe një herë, ky komision nuk funksionon kështu: vjen këtu, të pihet diçka, e porosit dhe të vjen. Të gjitha mediet janë të lira të transmetojnë si të duan, çfarë të duan dhe ku të

duan. Nuk kam ndaluar askënd që të transmetojë. Këtu janë dhjetë kamera, le të bëjnë çfarë të duan, nuk më intereson kjo pjesë!

Në qoftë se keni për të folur, flisni. Në qoftë se nuk keni për të folur, çfarë t'ju them unë?!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Flamur Noka – Më falni, mundem?

Erion Braçe – Po, urdhëroni!

Flamur Noka – Zoti kryetar, pavarësisht se, për fat të keq, axhenda e të dyja palëve këtu është krejt tjetër, ju keni axhendën në lidhje me ligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar, ndërsa ne kemi një axhendë tjetër, që, sipas nesh dhe atyre që përfaqësojmë, është më sensitive sesa kjo axhendë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për shkak se po rrëmbehet një pronë, për shkak se po vidhet një pronë në mes të Tiranës, e cila, me ligj, po vidhet për t'ia dhënë një firme private për të pastruar paratë e drogës në këtë vend! Ky është alarm dhe një shqetësim shumë i madh, sepse ky tregon nivelin e degradimit të shtetit! Kjo tregon korrupsionin e pushtetit! Kjo tregon arrogancën me të cilën po qeveriset! Pra, të gjitha këto elemente përbëjnë çështje shumë sensitive dhe krejt madhore.

Erion Braçe – Për ju.

Flamur Noka – Sigurisht, për ne dhe për qytetarët.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tani, për ju mund të mos jetë çështje sensitive se vidhet një pronë prej 5500 metrash, ku do të ndërtohet dhe do të vidhen aty 220 milionë dollarë, pra për ju mund të mos jetë e rëndësishme, por për ne dhe për opinionin publik është e rëndësishme, sepse, kur vjen qeveria dhe vjedh në mënyrë kaq flagrante, është problem i madh, dhe është një alarm për çdo qytetar në çdo vend të Europës dhe të botës së qytetëruar, jo vetëm këtu!

Madje edhe vendet e Botës së Tretë besoj se nuk kanë qeveri kaq harbute dhe kaq arrogante që vjedh në këtë mënyrë dhe që ndalon transmetimin në medie të shqetësimeve apo problematikave që ngre opozita!

(Kryetari i komisionit flet njëkohësisht me deputetin Noka.)

Në rast se ju nuk merreni me transmetimet, ju jeni kryetari i komisionit...

Erion Braçe – Patjetër, nuk merrem unë fare!

Flamur Noka – Dakord, ju jeni kryetari i komisionit dhe kur një pjesë e komisionit, në këtë rast opozita, kërkon pesë minuta pushim për një arsye të saj, ju duhet ta merrni në konsideratë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sepse nuk është një gjë kaq e paqenësishme, siç e konsideroni ju dhe siç doni ju ta përcillni, por po rrëmbehen 5500 metra katrorë tokë në qendër të Tiranës!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po u thuhet qytetarëve se nuk do të rrëmbehet dhe nuk do të ndërtohet kullë, ndërkohë që dje gjithë ditën, në të gjitha komisionet ku është diskutuar, është paraqitur projekti, ku thuhet se sipërfaqja prej 5500 metrash katrorë të Teatrit Kombëtar është e planifikuar. Pra, duket qartë se do të ndërtohet një kullë.

Shqetësimi është serioz dhe madhor.

Jua thashë dhe po e përsëris, nuk ekziston në botën demokratike një qeveri që t'u rrëmbejë qytetarëve të vendit të saj një sipërfaqe të tillë në qendër të kryeqytetit për t'ia dhënë një oligarku, i cili është përfituesi i të gjithë tenderëve të Bashkisë së Tiranës në kohën kur drejtohej nga Kryeministri, si dhe tani, në kohën kur drejtohet nga “zogu” i Tiranës! Pra, në të dyja kohët, ky është përfituesi numër 1, çka na bën të dyshojmë për lidhje të plota dhe të qarta korruptive të këtij oligarku me pushtetin.

Alarmi tjetër, për të cilin opozita është shumë e shqetësuar, është alarmi që ka ngritur edhe Banka e Shqipërisë, e cila relatton: “Në vendin tonë sot...” ose në Tiranën e sotme “...po gëlojnë ndërtimet dhe është kulmi i ndërtimeve në këtë qytet”. Pra, ndërkohë që Banka e Shqipërisë thotë: “Ndërtimet po njohin maksimumin historik në këtë qytet”, kredia nga biznesi për ndërtimet është në minimumin e saj historik, çka do të thotë se në Shqipëri, me bekimin qeveritar e të Kryeministrit, me bekimin e kësaj qeverie dhe të kësaj maxhorance, po pastrohen paratë e drogës!

Ndaj, ky është shqetësim edhe për ne, edhe për qytetarët, sepse po ndodhin fenomene që nuk kanë ndodhur kurrë, madje as diktatura nuk ka guxuar deri në këtë farë shkalle të kurajës që po tregoni ju!

Është shqetësuese vjedhja, është shqetësues pastrimi i parave të drogës, si dhe arroganca me të cilën silleni, prandaj duhet të kemi parasysh se kjo është një çështje që, doni apo nuk doni ju, prevalon mbi të gjitha!

Unë e di se Kryeministri nuk e ka fare problem, as “zogu” i Tiranës, megjithëse po u vjedh tokën qytetarëve, megjithëse po ndërton kullë mbi pronën publike, t'u thotë: “Jo, nuk

po jua vjedhim dhe nuk po jua ndërtojmë”, siç tha edhe për negociatat. Pra, në një kohë kur e gjithë Europa deklaroi qartë se negociatat nuk hapen dhe nga pesë kushte, shtuan tetë, dhe u bënë trembëdhjetë të tilla, në Maqedoni, shtet njëkohësisht kandidat me ne, kryeministri dhe të gjithë zyrtarët thanë atje se negociatat nuk u hapën, por diskutimi për hapjen e tyre u shty për vitin tjetër. Vetëm Kryeministri ynë, me pafytyrësinë që e karakterizon, së bashku me maxhorancën doli dhe shpalli festë në Shqipëri se u hapën negociatat. Të njëjtën gjë po thonë për Teatrin. Gjatë gjithë ditës mundohen t’i mashtrojnë, sy më sy, qytetarët duke u thënë se nuk do të rrëmbehet toka, nuk do t’ju vidhet, ndërsa nga ana tjetër, vjen në komisione projekti i miratuar, ku, pikërisht për atë tokë që thuhet se nuk do të vidhet, janë planifikuar kulla.

Po ju them se vlera e sasisë së parave që do të përfitohet apo që do t’u vidhet qytetarëve të Tiranës me ndërtimin e këtyre kullave është 220 milionë euro. E kuptoni sa e tmerrshme është?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tani, a mund të ketë ky komision, a mund të ketë ky parlament axhendë tjetër përveç kësaj?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kaq kisha.

Erion Braçe – Atëherë, po më thonë se kjo puna e transmetimit, pa dijeninë time, qenka rregulluar. Kështu, po jua provoj edhe një herë tjetër se unë nuk jam drejtor televizioni dhe nuk merrem me këtë punë.

Në qoftë se ju, si parti, kontrolloni mediet në këtë vend, patjetër, vazhdoni kontrollojini, vërinë në punë të transmetojnë ose jo live, qoftë edhe në sallat e komisioneve. Kjo është puna juaj, jo imja, se nuk merrem me këtë punë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E dyta...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mund t’i thoshit zotit Noka më përpara, apo jo, apo nuk keni hierarki brenda partisë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mund t’i thoshit zotit Noka më përpara që të respektonte zonjën Tabaku!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Flamur Noka – Zoti Noka i mori leje zonjës Tabaku, njëkohësisht edhe juve, si kryetar i komisionit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe – Mua jo!

Flamur Noka – ...në respekt të institucioneve!

Erion Braçe – Mua jo!

Flamur Noka – Ama, ka një gjë: ne, si opozitë, nuk komandojmë, se dihet kush i ka blerë, kush i ka futur në xhep mediet...

Erion Braçe – Lëre tani, Flamur!

Flamur Noka – Maksimumi që ne bëjmë është ngritja e zërit që të ketë transmetim. Pse? Sepse qytetarët duhet t'i dinë...

Erion Braçe – Zoti Noka...!

Flamur Noka – ...se cilat janë problemet që shtrohen këtu.

Erion Braçe – Zoti Noka, që, jo ju, por që kryetari i partisë suaj kontrollon të paktën tri televizione në këtë vend, këtë e dinë të gjithë, krejt hapur!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dhe këto janë tri televizionet më të rëndësishme në vend, që i kontrollon kryetari juaj!

Ndërhyrje nga salla pa mikrofon: ERTV-në!

Flamur Noka – Ato kulla që po ndërtohen...

Erion Braçe – “ERTV-në” mund ta bësh MSTV. Ata që marrin vesh nga teknologjia, e bëjnë...

Flamur Noka – ... janë pjesë e shpërblimit edhe ndaj pronarëve të medieve për t'i kontrolluar. Dihet publikisht, madje ka edhe raporte...

Erion Braçe – Zoti Noka, ju dëgjova shumë mirë!

Flamur Noka – ...ku thuhet se në Shqipëri mediet kontrollohen politikisht, nga pushteti.

Erion Braçe – Nga ty, more!

Flamur Noka – Nga pushteti.

Erion Braçe – Po pra, nga partia jote!

Flamur Noka – Nga pushteti, se opozita nuk ka!

Erion Braçe – Ekzaktësisht nga partia jote!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mos më detyro të filloj të flas me emra televizionesh, tani! Aman, të lutem!

Flamur Noka – Jo, fol, por...!

Erion Braçe – Po flas pra: i ke në partinë tënde; i kontrollon ti nga partia jote; i paguan ti nga partia jote, me para në dorë!

Flamur Noka – I paguan Kryeministri!

Erion Braçe – Lëre tani, mos na detyro të flasim!

Flamur Noka – I paguan Kryeministri me leje ndërtimi...

Erion Braçe – Po, patjetër.

Flamur Noka – ...me para të pista, me kulla dhe me të gjitha!

Erion Braçe – I ka paguar Lulzim Basha, me leje ndërtimi... Madje, e di se çfarë thonë? Thonë: “Ky është alamet burri, se nuk t’i përmend asnjëherë!”

Flamur Noka – Nuk është çfarë thonë, por se çfarë është realitet.

Erion Braçe – Lëre tani, se e di edhe ti këtë punë!

Flamur Noka – Zoti kryetar, kush tha se nuk do të ketë asnjë kullë në Tiranë dhe kush po e mbush Tiranën me kulla...?

Erion Braçe – Nuk më intereson fare.

Flamur Noka – Nuk të intereson fare? Nuk të intereson ty, por shqiptarëve u intereson, se po u shkatërrohet kryeqyteti, po u vidhet prona në kryeqytet!

Erion Braçe – Zoti Noka, mua kur më dalin përpara, u them, madje mos e ki merak fare këtë pjesë...

Flamur Noka – Shpresoj dhe besoj që...

Erion Braçe – E kam thënë aq sa...

Flamur Noka – ...të kanë devijuar rrugën, nuk të kanë lënë të kalosh nga ajo rrugë kur u ke dalë përpara!

(Kryetari i komisionit dhe deputeti Noka flasin njëkohësisht.)

Erion Braçe – Tani, ta lëmë këtë pjesë!

E nderura zonja Tabaku,

I nderuar zoti Noka,

E kërkuat fjalën për procedurë, por, në fakt, nuk folët për procedurë; folët për thelbin e gjësë!

Në bazë të nenit 49 “Çështjet e procedurës”, natyrisht, ajo që bëtë ju është e ndaluar nga Rregullorja e Kuvendit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këtu përpara nuk kam as statutin e partisë, as statutin e PD-së, por kam Rregulloren!

E dyta, në nenin 31 “Ndryshimi i rendit të ditës”, lidhur me atë që po kërkonte ju, thuhet: “Kuvendi ose komisionet nuk mund të diskutojnë dhe të vendosin për çështje që nuk janë në rendin e ditës. Këto çështje, sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni të Rregullores, vendosen nga Kuvendi”, pra vendosen nga seanca plenare.

Siç ju shpjegova edhe dje, unë nuk jam këtu për të bërë punën tuaj.

Në rast se ju nuk e bëni punën tuaj në përputhje me këtë Rregullore dhe të kërkonte, pikërisht, ato gjëra që po i kërkonte, atje ku kërkohen (në Konferencën e Kryetarëve, në seancë plenare) dhe të vendosen nga ato institucione, unë nuk kam çfarë t’ju bëj dhe kjo mbaron këtu!

Unë punën tuaj nuk e bëj.

Së treti, axhendën e këtij komisioni nuk e vendos Partia Socialiste, por Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe ky komision ka detyrim të zbatojë axhendën e vendosur nga Kuvendi.

Flamur Noka – Pikërisht ky është shqetësimi ynë, zoti kryetar.

Erion Braçe – Të lutem, ju dëgjova dhe nuk ju ndërpreva në asnjë moment! Pra, është axhendë që vendoset nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe ne jemi të detyruar ta zbatojmë atë. Në rast se ju kërkonte që ky komision të diskutojë një çështje të caktuar, u thashë edhe dje kolegëve tuaj, sepse ju nuk ishit, por po ju them edhe juve sot, referojuni Rregullores dhe kërkonte që kjo çështje të shqyrtohet. Unë punën tuaj me zor nuk e bëj! Bëni punën tuaj që të shqyrtohen gjërat që ju kërkonte. Në rast se ju nuk e bëni, nuk është faji im. Keni njerëzit tuaj në të gjitha forumet e Kuvendit, që marrin vendime. Ta kishin ngritur këtë çështje dhe të kërkonin këtë gjë. Më vjen keq, sepse asnjë nga kolegët që shikoni këtu nuk ka qenë dje në një komision tjetër, përveç këtij, dhe nuk kanë dijeni se për çfarë flisni ju. Po e përsëris edhe një herë atë që thashë dje, kam kërkuar sqarimet e mia me shkrim, në cilësinë time si deputet i Kuvendit të Shqipërisë dhe po pres t’i marr, pastaj mund të bëjmë debat ku të doni dhe si të doni. Unë pa letra zyrtare nuk flas dot. Ju keni metodë tuajën, flisni pa asnjë dokument, pa asnjë letër dhe pa asgjë, por kjo është çështja juaj dhe unë nuk ju hyj fare në këtë pjesë. Më mjafton vetëm një element për të konfirmuar që ju flisni pa letra, dje këtu u tha 8 mijë metra katrorë, ndërsa ju vini sot dhe thoni 5500, pasdite do të dalë dikush dhe do të thotë 4200, një tjetër do të dalë dhe do të thotë 3200, 2 të tjerë do të dalin të thonë 2000 dhe kështu me radhë. Kjo është një histori që nuk mbaron kurrë, kështu që unë nuk flas dhe as nuk diskutoj dot për gjëra, për të cilat nuk ka dokumente dhe, së dyti, për gjëra që janë jashtë rendit të ditës. Në qoftë se doni të diskutoni një çështje që nuk është e përfshirë në rendin e

ditës, ju lutem referojuni Rregullores së Kuvendit dhe vazhdoni ndiqni rregullat e saj. Po të ishit të ftuar në komisionet e tjera, pa asnjë lloj diskutimi që do të vija të flisja me ju. Do të ishte më mirë që kjo çështje të ishte diskutuar në Komisionin e Ekonomisë, por, për fat të keq, u gjykua që nuk do të diskutohet këtu dhe ju nuk e kërkuat këtë. Nuk e di se çfarë keni me mua, por problemi është se ju vendosët që të diskutohej në komisionet e tjera. Kështu që vazhdoni diskutoni atje, sepse nuk janë pak, janë 3 komisione që po e diskutojnë këtë çështje dhe e mbyllim këtë histori.

Jorida Tabaku – Së pari, i vetmi televizion që transmeton këtë mbledhje është TVSH-ja, që besoj se të gjithë e kanë të qartë që nuk ka asnjë lidhje me Partinë Demokratike. Në fakt, Partia Demokratike ka kohë që nuk transmetohet nga të gjitha televizionet kombëtare të vendit, kështu që akuzat për blerje televizionesh dhe sinjale transmetimesh në këtë rast janë në drejtimin e gabuar dhe ashtu siç thotë edhe OSBE-ja: “Media në këtë vend është e gjitha e kapur nga qeveria” dhe kjo nuk ka asnjë diskutim.

Për t’iu kthyer çështjes, e cila lidhet edhe me ligjin e TVSH-së që qeveria prezanton sot këtu, prona publike po grabitet dhe për këtë ne kemi kërkuar informacione në të gjitha komisionet parlamentare. Unë po publikoj kontratën e shitblerjes së truallit në vitin 1938 nga familja Libohova, që i është shitur përfaqësuesit të shtetit italian Jakomonit. Në këtë kontratë thuhet specifikisht se ai që e blen truallin, nuk e përdor dot për asnjë destinacion tjetër, përveçse për teatër. Edhe qeveria italiane ka qenë më largpamëse sesa qeveria shqiptare sot, e cila sillet si pushtuese e trojeve publike.

Në këta 5 vjet unë i kam bërë thirrje qeverisë të tërheqë të gjitha ligjet që kanë lidhje me grabitjen e pronës private. Ka pasur ligje, që u marrin pronën private pronarëve të vjetër të këtij qyteti dhe ua japin investitorëve strategjikë; ka pasur ligje që grabisin pronën dhe e kompensojnë me çmimin qesharak të Enver Hoxhës, por kurrë nuk ka ndodhur që prona publike të grabitet ditën për diell dhe e fundit futet një ligj në parlament me procedurë të përshpejtuar dhe askush nuk e ngre zërin.

Zoti Braçe, unë kam kërkuar që ky ligj të diskutohet këtu në komisionin tonë, por është vendosur ndryshe. Fatkeqësisht, ne nuk jemi maxhorancë, ne e kemi ngritur zërin, edhe zoti Spaho e ka kërkuar, por nuk e vendosim ne, e vendosni ju.

Askush nuk e kupton më mirë se Komisioni i Ekonomisë grabitjen e pronës, faktin që zëvendësministri i Financave ka firmosur dhe ministri nuk ka pasur guximin ta firmosë dhe faktin që këtu po pastrohen paratë e drogës. Përveç grabitjes së pronës publike, krimi më i rëndë që po bëhet është pastrimi i parave të drogës.

Në fakt, ashtu siç keni kërkuar ju informacion, edhe ne e kemi kërkuar. Kemi kërkuar informacion për pronën publike në dispozicion dhe qeveria shqiptare nuk ka dhënë dy herë të njëjtin variant. Siç thotë dokumenti i vitit 1938, që prona publike është 10 mijë metra në dispozicion të truallit të teatrit, ndërsa sot janë 8500 pronë publike, ku 5500 metra i përkasin bashkisë, e gjitha po vidhet dhe po grabitet. Ngjitur me këtë projekt është projekti i financuar nga Bashkimi Europian “Pedonalia”, 5 milionë euro, e cila do të prishet, pasi do të ndërtohen kulla. Ngjitur me hotel Tiranën përsëri ka një plan tjetër për të ndërtuar kulla. Kryetari i bashkisë paralajmëroi se do të prishë edhe Galerinë e Arteve dhe do të ndërtojë kulla. Nuk e di se çfarë alarmi më të madh mund të ketë në këtë vend sesa grabitja e pronës publike. Pronarët privatë i trajtoni si lecka dhe nuk u jepni pronën, ndërsa pronën e shtetit e merrni dhe ia jepni privatit. Unë nuk e di se çfarë regjimi mund ta quajmë këtë?! Ta quajmë diktaturë, komunizëm?! Por as Enver Hoxha nuk bëri këtë që po bën Edi Rama.

Kompleksi i ministrive, universiteti, kompleksi i ndërtuar me teatrin dhe kompleksi Skenderbej janë ndërtesat e vetme të vjetra që ka qyteti, por të gjitha po prishen dhe rrënohen, ndërkohë që pronarëve privatë nuk u jepni mundësi ta zhvillojnë pronën e tyre.

Unë e di shumë mirë se shumë nga deputetët socialistë janë të interesuar të flasin për këtë çështje dhe shumë nga ata nuk janë dakord. E di që në këtë komision nuk keni informacion, sepse, po të kishit, edhe ju do të votonit kundër. Është e papranueshme ajo që ka ndodhur dhe në komisionet parlamentare. Jam e sigurt se po të diskutohej në këtë komision, ndoshta do të kishte më shumë transparencë, por dhe shfaqja e shtetit shqiptar ka qenë e turpshme. Askush nuk kthen përgjigje, askush nuk e di se çfarë ka firmosur, askush nuk e vë në dispozicion projektin dhe askush nuk jep përgjigje pse kanë firmosur për të grabitur pronën.

Meqenëse zëvendësministri i Financave është këtu, le të na kthejë ai përgjigje, sepse ai është pjesë e fushës së përgjegjësisë së Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave. Si ka firmosur Ministria e Ekonomisë dhe Financave një procedurë që nuk është as procedurë tenderi dhe as prokurimi dhe është e firmosur një kërkesë e një kompanie dhe vjen e bëhet ligj në parlament? Unë jam e sigurt se të gjithë deputetët këtu duan informacion se si ka mundësi që një privat të bëjë një kërkesë dhe të ngrihet një parlament i tërë të propozojë një ligj. Kjo është çështja që duhet të prevalojë në të gjitha komisionet parlamentare dhe jo ligjet që vijnë këtu si fasadë, i ndryshoni nga 30 herë dhe nuk hynë në fuqi këtë vit, por i përgatisni për vitin tjetër.

Presidenti mund ta kthejë këtë ligj, i cili do të kalojë në parlament ditën e enjte, përsëri do të diskutohet në komisione parlamentare dhe do të votohet në seancë dhe jam e sigurt se ju do ta votoni pro, sepse jeni bërë të gjithë gardh për të mbrojtur krimin dhe korrupsionin. Unë e di shumë mirë se ata që nuk firmosin, Kryeministri, ministri i Financave dhe kryetari i bashkisë kanë frikë, sepse e dinë që nesër janë para përgjegjësisë, por ata kanë detyruar zëvendësministrat dhe zëvendëskryetarët e bashkisë që të firmosin, pasi kjo grabitje e pronës publike herët ose vonë do të gjejë përgjigje. Herët ose vonë, ata që kanë firmosur këtë grabitje të pronës publike nuk e kanë vendin në zyrat e shtetit, por e kanë në burg.

Faleminderit!

Erion Braçe – Zonja Tabaku, ju thashë edhe dje që marrëdhënia me të vërtetën është shumë e rëndësishme. Patjetër që nuk e keni më Televizionin Shqiptar dhe nuk e përdorni siç e keni përdorur qëmoti, por problemi është se ishit *live* dhe ishit në 4K edhe në një televizion tjetër...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Falë insistimit tënd. Zonja Tabaku, edhe një herë...

Flamur Noka – Zoti kryetar, deri para 5 sekondash the që nuk merresh me mediat, ndërsa tani po merresh me transmetimin *live*.

Erion Braçe – Patjetër kur akuzoni!

Flamur Noka – Ky është treguesi që ju kontrolloni mediat dhe menaxhoni çdo gjë që del në media.

Erion Braçe – Zoti Noka, unë kam mësuar që të bëjë *screenshot* në telefon dhe falë insistimi të zyrës së Partisë Demokratike, siç thotë zonja Tabaku, është transmetuar në 4K *live* në një televizion tjetër.

Së dyti, zonja Tabaku, dua t'ju kujtoj se Kuvendi ose komisionet nuk mund të diskutojnë dhe të vendosin për çështje që nuk janë në rendin e ditës. Ju mund të kërkonit që në rendin e ditës të ketë çdo gjë që vendosini ju te Partia Demokratike, por ky institucion nuk ka për detyrë që të marrë porosi në mëngjes dhe të vazhdojë me menunë tuaj, ndërkohë që ka menu në seancë plenare të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Kështu që pa asnjë lloj diskutimi unë mendoj se çështja që kemi përpara apo çështja që kemi pasur dy ditë me radhë përpara janë çështje të rendit të ditës, janë diskutuar në këtë komision, ju keni pasur opinionet tuaja dhe janë çështje që ky krah këtej ka pasur pa diskutim opinionet e veta, ka diskutuar me grupet e interesit dhe ka materializuar të gjithë interesin kombëtar të këtyre grupeve në tri projektligje shumë të rëndësishme, që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me interesat e qytetarëve të

Republikës së Shqipërisë, posaçërisht të atyre që merren me sipërmarrjen private në fshat dhe në qytet. Kështu që, më duhet t'ju kujtoj edhe një herë tjetër që në këtë komision do të diskutohet në raport me rendin e ditës. Në rast se ju kërkoni ndryshim të rendit të ditës, pa asnjë lloj diskutimi, zbatoni rregullat e parashikuara nga Rregullorja e Kuvendit dhe unë do të jem partizan në mbështetje të kërkesave tuaja.

Së dyti, pa hyrë në thelb të gjësë, por duke u nisur nga deklarata juaj për vjedhjet marramendëse që janë kryer në këtë vend, po ju kujtoj se, zonjë, unë nuk e di ku keni qenë ju, por këtu në parlament është votuar për të vjedhur me themele kompaninë “Armo” dhe pastaj darovitjen e saj deri në ditët e sotme nga njëri tek tjetri, duke i dhënë fund një ndërmarrjeje shumë të rëndësishme strategjike dhe publike.

Këtu në këtë parlament është votuar për të vjedhur kompaninë që atëherë quhej “OSSH” për nevoja të integritetit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mos u shqetëso, zoti Spaho. Për nevoja të integritetit, jo për nevoja ekonomike; këtu në këtë parlament është vendosur vjedhja marramendëse e kompanisë OSSH. Këtu në parlament iu hap rruga vjedhjes galopante te portit të Durrësit në një seri koncesionesh, që në fillim i paguante qeveria e Republikës së Shqipërisë, pastaj shkonin te privati, kalata 1, kalata 2, kalata e trageteve, kalata e peshkimit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Drejtësinë tregojë Adriatik Llallës, jo mua. Pra, më lejoni t'ju them se porti i Durrësit është një nga asetet më të mëdha publike që ka ky vend dhe këtu në parlament iu hap rruga vjedhjes së tij. Ju vazhdoni të mbronin investitorin e huaj të asaj periudhe, por këtu në parlament iu hap rruga edhe vjedhjes së fushave të naftës, duke filluar nga Patos-Marinza dhe duke përfunduar në Gorisht-Këcul. Dakord? Këtu në parlament u denoncua, por askush nga ju nuk e hapi gojën kur qeveria vendosi t'i shesë hotel “Dajtin” Bankës së Shqipërisë, e cila, për t'iu përgjigjur me para në dorë qeverisë, emtoi monedhë dhe nuk përdori shpenzimet e veta. Në qoftë se ka një çështje që duhet të ishte këtu ministri i Financave dhe kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, i cili duhet duartrokitur që e ka zbuluar këtë fakt, është kjo. Kjo është çështja që duhet të shkonte urgjent në prokurori. Ky komision do të kërkojë që çështjen e blerjes së hotel “Dajtit” me para të emetuara, duke cenuar politikën monetare dhe duke cenuar rënde edhe statusin e Bankës së Shqipërisë, ta çojë në prokurori. Këto janë vjedhje! Me kaq sa ju numërova, shifra shkon mbi 1,5 miliardë të vjedhura me një dore në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

Flamur Noka – Zoti kryetar, më fal, lëri dokrrat, këto janë dokrra! Po të kishin qenë një nga këto që thua ti... lëri këto përralla se ti do të justifikosh këtë që po bëhet duke u hedhur hi syve shqiptarëve.

Erion Braçe – Zoti Noka, unë nuk u hedh hi syve shqiptarëve...

Flamur Noka - Po vidhet prona publike. Ky Kuvend po shndërrohet në një noter të vjedhjes së pronës publike, të pastrimit të miliardave të drogës..

Erion Braçe – Zoti Noka, duhet t’i provosh këto që thua...

Flamur Noka- Ky Kuvend po shndërrohet ... Ja ku është prova!

Erion Braçe – Një letër, zoti Noka. Zoti Noka, ke qenë ministër i Brendshëm dhe unë besoj se ju duhet të ...

Flamur Noka – Familja Libohova i ka shitur qeverisë italiane të asaj kohe 10.000 metra katrorë, nga të cilat 8000...

Erion Braçe – Qeveria italiane e asaj kohe ishte qeveri e pushtimit fashist të Shqipërisë.

Flamur Noka – Më pushtuese për shqiptarët është kjo qeveri, sepse ajo qeveri, pikërisht se ishte pushtuese, nuk pushtoi pronën, por ndërtoi teatër, ndërsa kjo qeveri....

Erion Braçe – Zoti Noka, duhet të kesh prova dhe nuk ke prova.

Flamur Noka – Prandaj mos kërkoni pse nuk po hapen negociatat. Këto janë arsyet që nuk po hapen negociatat, sepse negociatat nuk mund të hapen kur këtu shohin që vijnë miliardat e drogës dhe çdo kullë që ndërtohen me para droge. Po ju them një gjë, për çdo kullë që ndërtohet me para droge në Tiranë do të ketë shtyrje të afatit të integritetit. Ky është shqetësimi, sepse po mbani peng fatin e shqiptarëve. Për çdo kullë që ndërton zogu i Tiranës këtu, bashkë me again e tij Kryeministër, çdo 1 ditë do të keni shtyrje të afatit të hapjes së negociatave.

Ja pra, kemi edhe dokumente.

Erion Braçe – Çfarë dokumenti është ai?! Ai është një dokument që ti i ke shitur tokën një qeverie fashiste.

Flamur Noka – Kjo është kontrata e familjes Libohova, që kanë shitur tokën me kushtin që nuk do të ketë tjetërsim, por vetëm teatër. ... dhe nuk e ka bërë këtë që ka bërë qeveria jote. Ky është problemi.

I doje letrat? Ja ku janë letrat.

Erion Braçe – Zoti Noka....

Flamur Noka – Noter i pastrimit të parave të drogës, noter i vjedhjes së...

Erion Braçe – Duhet prova.

Flamur Noka – Ja ku është dokumenti.

Erion Braçe – A e din cila është provë? Ti në ambientet e kompanisë CEZ duke marrë në pronësi asetet e kompanisë CEZ. Kjo është provë.

Flamur Noka – Kjo është provë?

Erion Braçe – Patjetër!

Flamur Noka – A doni prova? Ja, kjo është provë. Provë është rrëmbimi.

Kjo tokë po u vidhet qytetarëve të Tiranës dhe këtu do të investohen paratë e drogës, paratë e qeverisë, paratë e krimit të organizuar dhe paratë e korrupsionit që i keni

Erion Braçe – Duhet ta provosh zoti Noka!

Flamur Noka – A e di kush mund ta provojë?

Erion Braçe – Ti e provon.

Flamur Noka – E provon Banka e Shqipërisë, që thotë: “Ndërtimi është në kulmin e saj .. në Tiranë, ndërsa ...”. Me çfarë bëhen këto kulla?

Erion Braçe – Ky është komenti yt.

Flamur Noka- Jo, është i bankës qendrore.

Erion Braçe – Kur?

Flamur Noka – Pardje ka dhënë konferencë për shtyp.

Vërtetoje që nuk është. Banka ka deklaruar se në Tiranë kulmi i ndërtimeve janë me kulla dhe kreditë janë me minimumin e saj..., që do të thotë se këto kulla ndërtohen me paratë e korrupsionit qeveritar dhe këto kulla ndërtohen me paratë e trafikantëve të drogës. Pra, qeveritarët, duke filluar nga Kryeministri, ministrat, kriminelët dhe trafikantët e drogës po ndërtojnë kulla në Tiranë.

Erion Braçe – Provat, ku janë provat? Banka e Shqipërisë ... “Ndërtimi i rritur... 0,17%, pasuritë e paluajtshme 0,001%, zoti Noka. Këto janë prova?! Jo, këta janë numra

Flamur Noka - A e di se çfarë janë këto që po lexon ti? Këto janë njëlloj si ajo që tha Edi Rama, që u hapën negociatat, kur e gjithë bota tha se nuk u hapën negociatat.

Erion Braçe – Zoti Noka, kjo është poezi.

Zonja Gjylameti!

Blerina Gjylameti – Zoti kryetar, është absurde mënyra se si po zhvillohet kjo mbledhje...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Spaho, ju lutem më dëgjoni! Unë nuk ju ndërhyra, kështu që të lutem mos më ndërhy.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe – Zoti Spaho, unë po ju lexoj vetëm Rregulloren e Kuvendit.

Zonja Gjylameti, për procedurë.

Blerina Gjylameti – Zoti kryetar, nuk është absolutisht normale mënyra e zhvillimit të kësaj mbledhjeje, as për tonet e zërit dhe as për faktin që jemi totalisht jashtë rendit të ditës. Nëse kolegët e opozitës duan ta marrin fjalën, mund ta marrin me radhë dhe me tone zëri të ulura, siç i takon këtij vendi ku jemi mbledhur. Kjo nuk është normale. Nëse ju doni ta vazhdoni kështu këtë mbledhje, vazhdojeni dhe ne po largohemi, sepse më duket tërësisht absurde.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe – Zoti Angjeli, për procedurë.

Anastas Angjeli- Unë kam 7 mbledhje që dëgjoj të njëjtën histori dhe nuk kam folur asnjëherë. Ne kemi zhvilluar gjithmonë mbledhje dhe kemi diskutuar projektet që kanë ardhur dhe ju asnjëherë nuk ju ka penguar njeri që edhe gjatë diskutimit të projekteve të thoni atë që mendoni, qoftë për projektin, qoftë për problematikat e tjera. Kështu që përsëri është rasti që, duke diskutuar atë projekt, të mos bëjmë dy mbledhje, por të bëjmë një mbledhje për ato që mendoni ju, pastaj për projektin, si pjesë e dytë të teatrit, të mos themi gjë dhe të ikim.

Unë mendoj të bëjmë një kompromis, sepse nuk jemi këtu për të bërë rrëmujë kot. Ju nuk ju ndalon askush që të shprehni mendimin tuaj për çdo problem që keni. Fillojmë procedurën dhe gjatë saj merrni fjalën dhe thoni çfarë të doni për ligjin, për teatrin, amfiteatrin, stadiumin dhe për kullat, por kështu nuk mund të vazhdojmë, sepse nuk bëjmë atë që duhet. Vazhdojmë mbledhjen dhe merreni fjalën me radhë. Kjo që po bëjmë nuk është normale, sepse po mundoheni të mbronin teatrin dhe njerëzit tallen me ne për teatrin që bëjmë këtu.

Erion Braçe - Zoti Spaho, për procedurë.

Edmond Spaho – Vërejtja juaj është e drejtë, por i duhet drejtuar kryetarit të komisionit, sepse në çdo rast që ne flasim, na duhet të dëgjojmë komentet e kryetarit për fjalën tonë, pastaj neve na lind e drejta për replikë dhe kështu nxehet situata dhe kalon tejet debatit normal. Sikurse e thatë, të flasim me radhë, ne ngremë argumentet tona dhe ju tuajat. Ne nuk e kemi fshehur se këtu vijmë për çështjen e teatrit dhe duam të sensibilizojmë qytetarët, madje edhe ju...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në të gjitha komisionet do të flasim deri sa t'i japim zgjidhje kësaj.

Erion Braçe – Kjo është dhunë.

Edmond Spaho – Kjo nuk është dhunë. Dhunë është kjo juaja, që me forcën e kartonit merrni vendime, të cilat u takojnë t'i marrin qytetarët dhe jo Edi Rama. Nuk i takon Edi Ramës që të prishë një objekt kulturor historik të ndërtuar para 80 vjetësh. Ajo ndërtesë ka qenë trashëgimi e atyre brezave që e ndërtuan, atyre që e shfrytëzuan, e këtyre që e shfrytëzojnë sot dhe e brezave të tjerë, kur Edi Rama të mos jetë më Kryeministër dhe për rrjedhojë nuk ka të drejtë të marrë ai vendime për të gjithë këta njerëz.

Edhe në vende të tjera, kur flitet për objekte të trashëgimisë historike dhe kulturore, bëhet me referendum, nuk bëhet në mënyrë arbitrare nga një maxhorancë dhe një Kryeministër, i cili ka 20 vjet që i ka hyrë kësaj aventure, o do ta prishë dhe të ndërtojë pallate atje, o s'ka! Prit, se këtu janë edhe interesat tona. Ne nuk duam që kjo ndërtesë të priset dhe kjo bëhet nëpërmjet një debati qytetar. Nëse e gjithë elita e këtij vendi thotë që nuk duhet prishur, atëherë nuk duhet.

Dokumenti që bëri publik zonja, tregon se ai është ndërtuar si teatër dhe hedh poshtë të gjithë atë që keni deklaruar gjatë këtyre muajve, javëve dhe ditëve që ai ka qenë kapon i ushtrisë italiane dhe mbaheshin kuajt. Ai që në fillim është konceptuar për teatër, madje është pjesë e një kompleksi rrethi kulturor italo-shqiptar “Skënderbej”. Më vjen keq që edhe autoritetet italiane nuk reagojnë për të ruajtur një element historik të prezencës tyre në Shqipëri. Edhe pushtimi i italianëve është histori jona, edhe që kanë zhvilluar të gjithë pjesën e qytetit të Tiranës, sepse, s'ka pse të na vijë turp, zhvillimet moderne të këtij qyteti kanë filluar me iniciativën e italianëve dhe me kredinë që kanë dhënë për të ndërtuar të gjithë bulevardin. Dikur në kohën e komunizmit u prish ish-bashkia (Komiteti Ekzekutiv), tani duhet të prishim edhe këtë qendër kulturore, që ka qenë e para e ndërtuar në kryeqytetin e Shqipërisë. Kini parasysh se Enveri e prishi atë objekt kur e zuri diabete dhe filloi të roiste, por..

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Shiko, nëse do ta dish, ky bulevardi tregon shpatat e Viktorit. Kur janë ngritur komunistët për herë të parë me avion, panë se ishte ngritur një simbol i fashizmit dhe Enveri dha porosi të mos prishen, por të ndërtohen objekte të tjera që të ç'konfigurohet. Prandaj po them se edhe ai që ishte diktator, trashëgiminë historike e ruajti, ndërsa ju po ngriheni ta prishni dhe po veproni më keq se ai. Është njësoj sikur të ngrihem tani dhe të prishim

Piramidën, Muzeun Historik dhe Pallatin e Kulturës, sepse janë objekte të ndërtuara në periudhën e komunizmit. Jo, kjo nuk mund të ndodhë, sepse ato janë trashëgimi historike jona dhe do të bashkëjetojnë me të gjitha zhvillimet e tjera, sepse ato dëshmojnë një periudhë 60-vjeçare tonën. E mirë apo e keqe, ato janë dëshmi historike, pse duhet t'i prishim? Pse duhet ta prishim teatrin e parë që ka pasur Tirana? Me këtë logjikë i bie që ne të shkojmë të prishim edhe Teatrin e Kukullave, sepse është një objekt i vjetër, nuk i kënaq kërkesat e sotme, por ju harroni se ai jo vetëm që ka shërbyer si teatër, por ka qenë edhe godina e parë e parlamentit. Pse duhet ta prishim teatrin për të ndërtuar kullë dhe teatër modern? Ka vende sa të duash për të ndërtuar teatër modern. Edhe në rrethin brenda qendrës së Tiranës mund të gjenden vende pa fund për të ndërtuar një teatër modern. Në qoftë se është e nevojshme, hajde ta ndërtojmë një teatër modern, po pse duhet ta prishim atë?! Çfarë i ka ngelur Tiranës? Pazari i vjetër u prish dhe ndërtuat atë pokaqinë "Pazarin e ri", që tani edhe e rikontsruktojnë dhe e tregojnë si trashëgimi. Çfarë trashëgimie ka aty? Pazari u prish kur u ndërtua Pallati i Kulturës...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ai është i riu, pazari historik i Tiranës e di ku ka qenë apo jo? Pazari historik u prish kur u ndërtuar Pallati i Kulturës.

Erion Braçe – Për procedurë.

Evis Kushi – Më vjen mirë që pas kaq mbledhjesh, me propozimin e zotit Angjeli dhe me konfirmimin e zotit Spaho arritëm në një kompromis që mbledhja të zhvillohet normalisht dhe ju sa herë të merrni fjalën të flisni për teatrin, ndërsa ne për rendin e ditës. Kështu që propozoj që mbledhja të fillojë me prezantimin e projektligjit, pastaj ju merreni fjalën për teatrin dhe ne për projektligjin.

Erion Braçe – Për procedurë.

Përparim Spahiu – Sot u zhvillua protesta e radhës së minatorëve dhe unë i përshëndes. Ua kam thënë atyre, ia them edhe opozitës, edhe artistëve që me këtë parlament dhe me këtë qeveri nuk ka zgjidhje tjetër përveçse protestave. Kështu që ata le ta vazhdojnë protestën, edhe ne do të vazhdojmë protestën, pasi nuk ka rrugëzgjidhje tjetër, sepse ana ligjore dhe këto historitë e tjera besoj se kanë rënë.

Për sa i takon çështjes së teatrit, dua të them vetëm dy fjalë. Ne dibranët kemi një shprehje "I ke hipur kalit mbrapsht". Fakti që diskutimi për teatrin nuk ka ardhur në Komisionin e Ekonomisë, duket një zgjidhje e zgjuar e kryetarit bashkë me deputetët...

(Bie termet)

Më mirë ta shemb tërmeti, sesa ne. Edhe kjo zyra duhet shembur.

Erion Braçe – Të ndërpritet mbledhja!

Përparim Spahiu – Të vazhdojë mbledhja.

(Ndërpritet mbledhja)

(Pas ndërprerjes)

Erion Braçe – Rifillojmë mbledhjen e komisionit, duke shpresuar që ajo çfarë ndodhi të mos ketë krijuar pasoja për njerëzit.

Zoti Zëvendësministër, fjala është për ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, ju lutem, se është ezauruar procedura përfundimisht!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në qoftë se e doni fjalën për diskutim, merreni më pas.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk ka më dhënie fjale për procedurë, sepse askush tjetër nuk ka folur deri tani për procedurë!

Urdhëroni, zoti Zëvendësministër!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Elton Haxhiu – I nderuar zoti kryetar i komisionit,

Të nderuar deputetë,

Përpara jush ndodhet projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 92 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”.

Në kuadër të mbështetjes dhe stimulimit të sektorëve dhe industrive prioritare të vendit, sektori i agroturizmit do të jetë, gjithashtu, një ndër prioritetet e vendit, me qëllim zhvillimin e turizmit në zonat rurale, shoqëruar kjo edhe me nxitjen e prodhimit dhe tregtimit të produkteve të zonës.

Parë në këtë këndvështrim, iniciativa e ndërmarrë synon të incentivojë krijimin dhe rritjen e këtij sektori, i cili pritet të ofrojë akomodim, ushqim, argëtim dhe veprimtari të tjera të lidhura me fermën ose njësinë agrokulturore.

Projektligji parashikon aplikimin e normës së reduktuar të tatimit mbi vlerën e shtuar 6% për furnizimin e shërbimit të akomodimit, restorantit, me përjashtim të pijeve, brenda strukturës që zhvillon veprimtari pritëse të certifikuar si agroturizëm, sipas legjislacionit të fushës së turizmit.

Ky ndryshim është njëkohësisht edhe në përputhje me direktivën e Bashkimit Europian, konkretisht me direktivën 112/2006, kreu VII, neni 49, i cili është në përputhje me nenin 98 të direktivës, i cili përcakton se, përveç shkallës së standardeve të TVSH-së, mund të aplikohet edhe shkalla e reduktuar. Në të njëjtën direktivë, gjithashtu, në aneksin III,

përcaktohen se cilat janë furnizimet e mallrave dhe shërbimeve, mbi të cilat mund të aplikohet norma e reduktuar e TVSH-së, ku listohen edhe furnizimet e mjaft shërbimeve dhe mallrave, të cilat mund të marrin një normë të reduktuar të TVSH-së.

Ky ndryshim vjen në vazhdimësi me ndryshimin e mëparshëm, që është bërë në ligjin e TVSH-së për të gjitha strukturat akomoduese. Me këtë ndryshim ne e shtrijmë aplikimin e normës së reduktuar të TVSH-së 6% edhe për strukturat e agroturizmit, të cilat, sipas legjislacionit të fushës së turizmit, klasifikohen, më konkretisht, si veprimtari pritëse, që zhvillohet në një formë a njësi tjetër agrokulturore, me qëllim tërheqjen e vizitorëve dhe shpeshherë duke u mundësuar atyre pjesëmarrjen në veprimtari bujqësore ose veprimtari të tjera ndihmëse që zhvillohen në atë mjedis bujqësor.

Agroturizmi mbështet zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm të zonave rurale nëpërmjet mbrojtjes së ambientit, ruajtjes së traditave dhe promovimit të produkteve tipike të zonës.

Këto kritere janë miratuar me vendimin nr. 22, datë 12.01.2018 e Këshillit të Ministrave dhe në vazhdimësi ato subjekte që certifikohen si të tilla do të përfitojnë këtë lehtësi tatimore me normën e reduktuar 6% të TVSH-së për shërbimet që përmenda më sipër.

Vlen të theksohet se paketa e TVSH-së është e koordinuar edhe me një reduktim, të cilin ju duhet ta keni diskutuar në seancat e mëparshme, në lidhje me tatimin mbi fitimin për të njëjtat struktura.

Duke ju falënderuar për vëmendjen, mbetem i hapur në qoftë se do të ketë pyetje!

Erion Braçe – Faleminderit, zoti Zëvendësministër!

Fjalën e ka zonja Kushi.

Evis Kushi – Faleminderit, zoti kryetar!

Projektligji i sotëm është pjesë e paketës fiskale që po diskutohet gjatë kësaj jave në Kuvend dhe parashikon disa masa lehtësuese në fushën e tatimit mbi të ardhurat, TVSH-në dhe taksat vendore. Konkretisht, projektligji parashikon reduktimin nga 20%, në 6% të normës së tatimit mbi vlerën e shtuar për furnizimin e shërbimit të akomodimit dhe restorantit të ofruar brenda strukturave në të cilat zhvillohet veprimtari pritëse, e certifikuar si agroturizëm. Kjo normë e reduktuar nuk ofrohet për furnizimin e pijeve të ofruara nga këto struktura.

E theksoj, norma e reduktuar e TVSH-së ofrohet për personat e regjistruar vetëm për zhvillimin e veprimtarisë së agroturizmit dhe jo për personat që, krahas kësaj veprimtarie, ushtrojnë edhe veprimtari të tjera ekonomike.

Kjo kërkesë është vendosur për të identifikuar saktë të ardhurat nga veprimtaria, punësimi, risku tatimor dhe tregues të tjerë, në mënyrë që të ketë transparencë dhe kontroll të plotë të kësaj veprimtarie dhe administrim eficient tatimor.

Hartimi i këtij projektligji është me rëndësi të veçantë, pasi ai synon të krijojë lehtësi fiskale dhe të nxisë zhvillimin e agroturizmit në vendin tonë. Zhvillimi i sektorit të turizmit në përgjithësi dhe i sektorit të agroturizmit, si pjesë përbërëse e tij, ka qenë dhe vijon të jetë një ndër prioritetet e ekonomisë sonë, e reflektuar kjo edhe në programin e qeverisë, edhe në Strategjinë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020, si dhe në Strategjinë e Zhvillimit të Zonave Rurale 2018-2020.

Dua të nënvizoj këtu se nevoja për këtë projektligj lindi pasi ligji për TVSH-në ka parashikuar reduktimin e normës së TVSH-së në nivelin 6% në strukturat akomoduese të fushës së turizmit. Por në ligjin “Për turizmin” agroturizmi nuk klasifikohet si strukturë akomoduese, prandaj edhe nuk mund të aplikohet shkallë e reduktuar e TVSH-së për këtë sektor. Pikërisht, për këtë arsye u paraqit nevoja për të hartuar një projektligj të ri për vendosjen e normës së reduktuar të TVSH-së në këtë sektor.

Gjithashtu, vlen të theksohet që sektori i agroturizmit, krahas reduktimit të normës së TVSH-së nga 20%, në 6%, për shërbimet e akomodimit dhe restorantit do të ketë edhe disa përfitime të tjera nga paketa fiskale që po shqyrtohet aktualisht, siç janë: reduktimi i tatimit mbi fitimin nga 15%, në 5%, si dhe përjashtimi nga taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja në fushën e agroturizmit.

Ndërkohë, unë kam një shqetësim, të cilin dua ta ngre për diskutim edhe me kolegët e komisionit, edhe me përfaqësuesit e ministrisë dhe më pas në formën e një propozimi, për të bërë disa ndryshime në këtë projektligj.

Konkretisht, projektligji i propozuar redukton në 6% TVSH-në për furnizimin e shërbimit të akomodimit dhe restorantit të ofruar brenda strukturave të agroturizmit, me përjashtim të furnizimit të pijeve. Këtu dua të ndalem në tri çështje që më duken të rëndësishme dhe që duhet patjetër t’i diskutojmë dhe t’i reflektojmë në projektligj.

Së pari, ajo që dua të evidentoj është se këto lloj strukturash akomoduese... Më falni, në këtë ligj ka një përcaktim se kush konsiderohet pije dhe në kushte të tilla gjithçka që është e lëngshme. Pra, në ligj nuk është e qartë se kush konsiderohet pije dhe për këtë arsye do të konsiderohet gjithçka që është e lëngshme, me apo pa alkool. Ndërkohë, projektligji e redukton me 6% furnizimin e shërbimit brenda strukturave të agroturizmit, me përjashtim të pijeve. Tani, ajo çfarë unë dua të theksoj është, së pari, këto lloj strukturash akomoduese, që,

ndër të tjera, kryejnë edhe mbarështimin e gjedhit dhe të bagëtive të imta, për rrjedhojë kanë si bazë të veprimtarisë së tyre qumështin dhe nënproduktet e tij, duke përfshirë dhallën, hirrën e të tjerë, që ndërkohë konsiderohen lëngje dhe që, sipas këtij ligji, nuk do të përjashtohen nga ulja e TVSH-së në 6%.

Së dyti, këto struktura pritëse kultivojnë edhe hardhi apo fruta të ndryshme dhe prodhojnë verëra të ndryshme apo produkte të tjera, si, për shembull, raki apo lëngje frutash. Rrjedhimisht, duke qenë lëngje, i bie që edhe këto të mos përfitojnë nga ulja e TVSH-së nga 20% në 6%.

Po ashtu, dua të theksoj që ne kemi miratuar shkallën e reduktuar të tatimit të TVSH-së 6% për çdo furnizim shërbimi brenda strukturave akomoduese hotel ose resort me pesë yje (status special), pra edhe për restorantet, edhe për të gjitha produktet që trajtohen në restorante, përfshirë të gjitha pijet me apo pa alkool.

Prandaj, bazuar në këto argumente, unë sugjeroj që edhe për strukturat pritëse të certifikuara si agroturizëm të ndiqet e njëjta politikë, të paktën për pijet e prodhuara prej tyre, qofshin këto pije me alkool ose pije pa alkool. Ndërsa në rastet kur këto struktura prodhojnë pije për t'i tregtuar në supermarkete apo në struktura të tjera mund të aplikohet TVSH-ja 20% ose akciza, ose çdo gjë tjetër. Por për ato struktura të agroturizmit, të cilat prodhojnë brenda strukturës së tyre pije me apo pa alkool, unë sugjeroj që...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, edhe që i konsumojnë brenda strukturave të tyre, unë sugjeroj që të përfitojnë nga ulja e TVSH-së, pra ulja e TVSH-së nga 20% në 6% të aplikohet edhe për këto lloj produktesh, edhe për këto lloj lëngjesh.

Për ta mbyllur, i sugjeroj komisionit që ta miratojmë këtë projektligj.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe – Ka pyetje?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka diskutime? Meqenëse nuk ka pyetje dhe diskutime, mbledhjen e mbylлим këtu.

Faleminderit të gjithëve për pjesëmarrjen!

Ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA